



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës më 20.01.2025

RAPORT

**PËR PUNËN KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E
VITIT 2024**

Të nderuar këshilltarë !

Në përmbushje të detyrimit të parashikuar në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, miratuar me Vendim nr.25, datë 29.04.2020 po Ju parashtrojmë “Raportin vjetor të punës së këshillit”. Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara mbi mbledhjet e këshillit, mbledhjet e komisioneve, vendimet e marra dhe konsultimet publike.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak Durrës mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli bashkiak.

Duke qënë se Këshilli si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit ka rol vendimmarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues, jemi munduar të ushtrojmë këto role duke u bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Këshilli i Bashkisë Durrës, gjatë 12-mujorit të vitit 2024 është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit. Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, jo vetëm nga fondi i kushtëzuar por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Durrës si më poshtë :

Nr.	Muaji	Ndihmë ekonomike për familje nga të ardhurat e Bashkisë	Ndihmë ekonomike për familje nga fondi i kushtëzuar 6 %
1.	Janar	-	-

2.	Shkurt	114	33
3.	Mars	124	34
4.	Prill	126	36
5.	Maj	124	39
6.	Qershor	135	36
7.	Korrik	135	36
8.	Gusht	137	35
9.	Shtator	137	35
10.	Tetor	141	33
11.	Nëntor	143	33
12.	Dhjetor	146	33

Kemi akorduar bonus strehimi si dhe ulje të vlerës së kontratës për familjet që përmbushnin kriteret ligjore për të përfituar nga fondet e akorduara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në favor të Bashkisë Durrës, gjithsej :

287 familje bonus strehimi me VKB. Nr.25 dhe VKB nr.109

15 familje ulje të vlerës së kontratës me VKB. Nr. 42

(ku përmendim invalidë, persona PAK, familje të komunitetit egjiptian ose rom, persona që gëzonin statusin e jetimit, apo kryefamiljare të divorcuara).

Gjithashtu këshilli ka marrë vendim për 1147 familje që kanë përfituar nga program i kredisë së lehtësuar për strehim me 3% interes me VKB nr.27 dhe VKB nr.108.

Në zbatim të aktit normativ nr.8, datë 07.12.2019 dhe aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 Këshilli i Bashkisë Durrës, ka marrë vendime të rëndësishme për periudhën janar - dhjetor 2024 për tërmetin gjithsej 36 vendime, ku pjesa më e madhe është për miratimin e listave të përfituesve nga programi i rindërtimit.

Krahas këtyre vendimeve kemi miratuar vendime për :

- Në lidhje me hartën e plazheve dhe vendbazimet e mjeteve lundruese. (VKB nr.3, 47, 69)
- Emërtim të objekteve arsimore. (VKB nr.11)
- Në lidhje me astete (për dhënie pa kundërshtpërblim institucioneve publike apo një shtesë kontrate me tarifën 1 euro) (VKB 17,18,24,32)
- Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit këshillimor për shqyrtimin e propozimeve për dhënien e titujve vendorë të nderit pranë Bashkisë Durrës (VKB nr.21)
- Bursat për nxënës të arsimit parauniversitar, profesional dhe konviktet e shkollave të mesme profesionale . (VKB nr.26, 43,116)
- Dhënien e titullit “Qytetar nderi” z.Mirush Kabashi pas vdekjes (VKB nr.34)
- Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës për disa prona (Katund i Ri, Kuçok, Vadardhë) (VKB nr.50,51,52,65).
- Nivelin të pagave të punonjësve të aparatit të bashkisë së Durrësit si dhe për miratimin e

nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të bashkisë Durrës (VKB nr.92,93,94,95,96).

- Për taksitë dhe subvencionim e operatorëve për transportin publik (VKB nr.13,99,102)
- Për shtesa në VKB nr.475/2017 në lidhje me sistemin e ri të adresave (VKB nr.35,46,87)
- Në lidhje me legalizimin e ndërtimeve pa leje (marrëveshje dhe buxhet) (VKB nr.90,98)
- Për miratim të vlerave të shpronësimeve në Vardardhë, TID, Porto-Romano (VKB nr.64,110,117)
- Ndihma Financiare lidhur me dëmet nga zjarret. (VKB nr.58,107)
- Për zonat dhe tarifat për parkimet publike (VKB nr.66)
- Për dhënie autorizimi kryetarit të bashkisë për të përfaqësuar bashkinë në Gjykatën Kushtetuese (VKB nr.70)
- Për dhënien e miratimit kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e Konventës për klimën dhe energjinë (VKB nr.106)
- Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2025. (VKB nr.113)
- Buxhetin e vitit 2025 dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2025-2027 (VKB nr.115)
- Gjithashtu Këshilli ka marrë dhe disa vendime që i përkasin mbarëvajtjes së punës së tij. (VKB nr. 15,53,54,55,103,111)

Për periudhën janar – dhjetor 2024, janë marrë 119 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Durrës.

(Sqarim : Bashkëngjitur materialit gjeni dosjen e vendimeve ku është përcaktuar saktë numri i vendimit, data e vendimit, data e shpalljes së vendimit, titulli i vendimit, data e miratimit nga Prefekti dhe nr.i fletëve të vendimit dhe dokumentave shoqëruese të tij, të cilat janë të publikuara dhe në faqen e internetit të Këshillit)

Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës kanë qenë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave. Për vendimet e marra nga ky këshill për 12 mujorin e vitit 2024 institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për të gjitha vendimet e marra.

Nga Prefektura Durrës është kryer kontroll sipas legjislacionit në fuqi dhe në raportet përfundimtare është cilësuar se Këshilli Bashkiak Durrës ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet ligjore, por rekomandon rishikimin e Rregullores në lidhje me problematika të hasura gjatë punës në vijim.

Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë për t’iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Durrësit.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 9 mbledhje të radhës, 2 mbledhje jashtëradhe dhe nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakondshme, sipas tabelës së mëposhtme:

Muaji	Nr i mbledhjeve	Mbledhje të radhës	Mbledhje jashtë radhe	Mbledhje të jashtëzakondshme
Janar	-	-	-	-
Shkurt	1	1 (06.02.2024)	-	-
Mars	1	1 (06.03.2024)	-	-
Prill	1	-	1 (16.04.2023)	-
Maj	1	1 (21.05.2024)	-	-
Qershor	1	1 (25.06.2024)	-	-
Total 6 mujor parë	5	4	1	-
Korrik	1	1 (29.07.2024)	-	-
Gusht	-	-	-	-
Shtator	2	1 (09.09.2024)	1 (24.09.2024)	-
Tetor	1	1 (28.10.2024)	-	-
Nëntor	-	-	-	-
Dhjetor	2	1 (16.12.2024) 1 (24.12.2024)	-	-
Total 6 mujor dytë	6	5	1	-

Total 12 mujori	11	9	2	-
------------------------	-----------	----------	----------	----------

Kalendari i zhvillimit të mbledhjeve paraqitet si më poshtë :

6 mujori parë 2024	Nr.	DATA E MBLEDHJES	ORA	VENDI I ZHVILLIMIT
	1.	06.02.2024	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak

	2.	06.03.2024	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	3.	16.04.2024	18:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	4.	21.05.2024	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	5.	25.06.2024	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
6 muajori dytë 2024	1.	29.07.2024	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	2.	09.09.2024	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	3.	24.09.2024	14:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	4.	28.10.2024	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	5.	16.12.2024	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	6.	24.12.2024	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak

Siç shihet dhe nga kalendari i mbledhjeve të gjitha seancat plenare Këshilli i ka mbajtur në Sallën e Këshillit Bashkiak. Vlen për tu përmendur se pjesmarrja e këshilltarëve ka qënë aktive në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare.

Pjesmarrja e këshilltarëve në mbledhjet plenare gjatë vitit 2024.

Muaji	Prezenca e këshilltarëve në sallë sipas mbledhjeve plenare
Janar	-
Shkurt	(06.02.2024) - 36
Mars	(06.03.2024) - 42
Prill	(16.04.2024) - 37
Maj	(21.05.2024) - 39
Qershor	(25.06.2024) - 38
Korrik	(29.07.2024) - 33
Gusht	-
Shtator	(09.09.2024) - 33 (24.09.2024) - 34
Tetor	(28.10.2024) – 43 33 gjatë mbledhjes se 10 bojkotuan
Nëntor	-
Dhjetor	(16.12.2024) - 43 (24.12.2023) - 39

Komisionet e përhershme të këshillit janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar projektvendimet e sjella nga administrata e Bashkisë Durrës. Për periudhën 12-mujore janë mbajtur 66 mbledhje të komisioneve të përhershëm.

Nr.	Muaji	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm
1.	Janar	-
2.	Shkurt	7
3.	Mars	7
4.	Prill	2
5.	Maj	9
6.	Qershor	10
	Total 6 mujori I-rë	35
7.	Korrik	5
8.	Gusht	-
9.	Shtator	3
10.	Tetor	7
11.	Nëntor	-
12.	Dhjetor	16
	Total 6 mujori II-të	31
	TOTALI 12 MUJOR	66

Gjatë kësaj periudhe Komisionet i kanë mbajtur mbledhjet e tyre në Sallën e Këshillit apo Zyrën e Sekretarisë së Këshillit.

Në çdo rast Komisionet e Përhershme në zbatim të “Rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës” kanë mbajtur raport apo procesverbal ku pasqyrohet vendimmarrja e secilit komision për pikat e rendit të ditës, që u janë caktuar për t’i shqyrtuar, sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr.	Komisioni	6 mujori parë 2024 RAPORTE E PROÇESVERBALE TE KOMISIONEVE sipas pikave të rendit të ditës					
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
1.	Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike	-	1r/9p	1r/7p	-	1r/6p	1r/5p
2.	Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	-	1r/1p	-	-	1r/1p	1r/2p

3.	Komisioni Mandateve	-	-	1r/1p	-	-	1r/1p
4.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	-	1r/7p	1r/10p	-	1r/9p	1r/9p
5.	Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave- Tarifave	-	-	1r/2p	-	1r/2p	1r/3p
6.	Komisioni Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë	-	-	-	-	1r/1p	1r/1p
7.	Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit	-	1r/1p	1r/3p	1r/2p	1r/3p	-
8.	Komisioni i Mardhënieve me Jashtë dhe Integrimi Evropian	-	-	-	-	-	-
9.	Komisioni Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve	-	-	-	-	-	-
10.	Komisioni Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale	-	1r/2p	1r/1p	1r/1p	1r/1p	1r/2p
11.	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	-	1r/1p	1r/5p	-	1r/3p	1r/3p
12.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik	-	-	-	-	-	1r/1p
13.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit	-	1r/1p	-	-	1r/1p	1r/1p
14.	Komisioni Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve	-	-	-	-	-	-
15.	Komisioni i Teknologjisë dhe Inovacionit	-	-	-	-	-	-
	Totali 6 mujori I-rë 35 (raporte/procesverbale)	-	7	7	2	9	10
		6 mujori dytë 2024 RAPORTE E PROÇESVERBALE TË KOMISIONEVE					

Nr.	Komisioni	sipas pikave të rendit të ditës					
		Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1.	Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike	1r/14p	-	-	1r/2p	-	1r/2p
2.	Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	-	-	-	-	-	1r/1p +1r/1p
3.	Komisioni Mandateve	-	-	-	-	-	-
4.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	1r/14p	-	1r/1p	1r/10p +1r/1p	-	1r/3p +2r/2p
5.	Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave	1r/2p	-	1r/1p	1r/7p +1r/1p	-	2r/4p
6.	Komisioni Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë	-	-	-	-	-	1r/1p
7.	Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit	1r/1p	-	-	-	-	2r/2p
8.	Komisioni Mardhënieve me Jashtë dhe Integrimi Evropian	-	-	-	-	-	-
9.	Komisioni Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve	-	-	-	-	-	1r/1p
10.	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit	1r/1p	-	1r/1p	1r/2p	-	1r/1p +1r/1p
11.	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	-	-	-	1r/2p	-	1r/1p +1r/1p
12.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik	-	-	-	-	-	-
13.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit	-	-	-	-	-	-

14.	Komisioni Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve	-	-	-	-	-	-
15.	Komisioni i Teknologjisë dhe Inovacionit	-	-	-	-	-	-
16.	Totali 6 mujori II-të 31 (raporte/procesverbale)	5	-	3	7	-	16

*	Totali 12 mujor	66 (raporte/procesverbale)
----------	------------------------	-----------------------------------

Komisioni i Mandateve ka propozuar 2 projektvendim dhe 2 relacion, që janë bërë vendime.

VKB nr. 15, datë 06.03.2024

VKB nr. 55, datë 25.06.2024

Kryetari Këshillit ka propozuar 3 projektvendime dhe 3 relacione, që janë bërë vendime.

VKB Nr. 53, datë 21.05.2024

VKB Nr. 103, datë 28.10.2024

VKB Nr. 111, datë 16.12.2024

Me propozim të kryetarit të Grupit të Partisë Socialiste

VKB Nr. 54, datë 21.05.2024

Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në:

- | | |
|---|---------------------|
| 1. për probleme financiare | - 19 vendime |
| 2. për probleme sociale | - 13 vendime |
| 3. për infrastrukturën dhe strehimin | - 46 vendime |
| 4. për problemet urbane dhe asetet | - 21 vendime |
| 5. për emergjencat civile | - 3 vendime |
| 6. për probleme të arsimit kulturës | - 7 vendime |
| 7. të ndryshme | - 10 vendime |

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe strehimin, konkretisht për familjet përfituese në kuadër të procesit të rindërtimit.

Vlen të përmendet fakti se gjatë këtij viti Këshilli Bashkiak miratoi plane si dhe ngritjen e një qëndre komunitare, si më poshtë si:

1. Planin e përmirësimit të shërbimit në arsimin parashkollor në bashkinë Durrës për vitet 2024-2026 (VKB nr.44).
2. Planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje e kullota të bashkisë

Durrës për vitin 2024 (VKB nr.45).

3. Ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Komunitare për shërbime sociale të integruara për familjen në njësinë administrative Sukth nga PNUD tek Bashkia Durrës (VKB nr.8).

Mbetet për detyrë implementimi i tyre në praktikë dhe për të arritur sa më mirë këtë duhet bashkëpunimi i të gjithë hallkave (përfaqësues, ekzekutiv, komunitet)

Në zbatim të programit të transparencës raportojmë si më poshtë :

Është përditësuar faqa online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun nëpërmjet kartelave të mëposhtëme :

- Rreth Këshillit Bashkiak
- Historiku i kryetarëve
- Struktura e Këshillit Bashkiak
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak
- Përbërja e Komisioneve
- Konferenca e Kryetarëve
- Legjislacioni
- Rregulloret
- Model formatesh për t'u shkarkuar nga komuniteti
- Kalendari Mbledhjeve të Këshillit
- Njoftime nga Këshilli Bashkiak
- Model formati për t'u shkarkuar nga Këshilltari në rast konflikt interesi
- Procesverbalet e mbledhjeve të KB
- Vendime të Këshillit Bashkiak
- Rrjete sociale të Këshillit Bashkiak
- Konsultimet Publike
- Raporte të Këshillit
- Regjistri elektronik i kërkesave, ankesave dhe vërejtjeve
- Regjistri i brendshëm i peticioneve dhe iniciativave qytetare
- Regjistri publik për transparencën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak
- Regjistri i projekt akteve për konsultim publik të Këshillit Bashkiak
- Dëgjesa Publike
- Buxheti i Këshillit
- Pyetësor për Buxhetin
- Buxheti për Qytetarët
- Aktivitetet e Këshillit
- është shtuar dhe kartela Këshilli në vite

Sekretariati i Këshillit ka zbatuar me korrektësi kërkesat e ligjit për njoftimet publike (*si në faqen zyrtare të Bashkisë, në media vendore, me email drejtuar OJF, Drejtorëve të bashkisë, Kryetarëve të Njësive Administrative, në këndin e informacionit në zyrën e mardhënieve me publikun në Bashkinë Durrës*) në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar dhe Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës.

Në protokollin e Sekretariatit kanë hyrë 104 shkresa zyrtare dhe kanë dalë 81 shkresa zyrtare. *(sqarojmë se disa shkresa nuk kanë patur nevojë për përgjigje pasi ka qenë për dijeni drejtuar kryetarit apo këshilltarëve, të cilëve sekretariati ia ka vënë në dijeni përmes postës elektronike apo aplikacioneve të tjera).*

Ka patur dhe kërkesa që janë trajtuar dhe janë koordinuar me ekzekutivin e bashkisë dhe në të gjitha rastet janë informuar qytetarët. Forma e komunikimit ka qenë me email ose me postë.

Këshilli duke ju përshtatur dhe risive të teknologjisë për përcimin sa më shpejt të njoftimeve apo komunikimit direkt me qytetarët ka dhe faqen e tij në rrjetin social facebook ku ka në të cilin bënë njoftimet për mbledhjet e tij si dhe merr vërejtje, ankesa, kërkesa e sygjërime nga qytetarë të ndryshëm.

Nuk kanë munguar as takimet direkte të këshilltarëve me banorët e Bashkisë Durrës dhe përcjellja e mendimeve të tyre në mbledhjet e komisioneve dhe në seancat plenare të këshillit. Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës në fund të çdo mbledhje është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë. Gjatë mbledhjeve plenare të këshillit kanë marrë përgjigje 28 kërkesë-ankesa.

Pjesë e transparencës dhe llogaridhënies ishte edhe organizimi i “*Sesionit Informues*” të Këshillit të Bashkisë që u zhvillua në sallën e këshillit ku pati për qëllim:

- Informimin për veprimtarinë tonë për periudhën pak më shumë se 1 vjeçare që nga konstituimi i Këshillit dhe dëgjimin e opinioneve dhe rekomandimeve të komunitetit me qëllim përmirësimin e punës sonë.
- Ky takim u transmetua drejtpërdrejt (live) në rrjetin social facebook.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit u paraqitën në këshill “Raporte të Bashkisë Durrës” në zbatim të VKB nr.180, datë 01.12.2023. Do ishte e nevojshme një bashkëpunim dhe një angazhim më i madh për ekzekutivin që të pregatisë në kohë raportet dhe informacionet e planifikuara për vitin 2024 me VKB nr.111, datë 16.12.2024, por edhe për rastet kur do të kërkohen nga këshilli.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014 “Për konsultimin publik” gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, këshilli në bashkëpunim me bashkinë ka mundur të zhvillojë dëgjesa publike për pika të veçanta të rendit të ditës, si plani i arsimit parashkollor, parkimi publik, etj....)

Administrata e bashkisë në bashkëpunim dhe me Këshillin Bashkiak sipas kalendarit të dëgjesave publike të hartuar për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026, u organizuan 18 dëgjesa publike në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës. Në këto 18 dëgjesa publike, morën pjesë rreth 399 qytetarë, përfaqësues të komunitetit, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendore, përfaqësues të biznesit, shoqëri civile etj., të cilët përfshinë të gjithë territorin e Bashkisë. Gjatë organizimit të këtyre dëgjesave publike, u diskutua për investimet dhe shërbimet

sipas programeve që ka kryer bashkia si dhe rekomandimet dhe sugjerimet e dala nga pjesëmarrësit. Vlen të përmendet fakti se pjesa më e madhe e propozimeve nga komuniteti u reflektuan në buxhetin e Bashkisë Durrës për vitin 2025.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj, me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit.

Del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative, të cilat do të diskutohen dhe vendosen në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohe apo shqyrtohet për të.

Përsa më sipër vlerësojmë përvojën pozitive dhe ndërkohë kërkojmë plane tuaja për dëgjesa në zonat ku banoni apo jeni caktuar për të kryer detyrën e këshilltarit.

Punë të mbarë për vitin 2025 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

- Falenderimet gjithashtu shkojnë për Administratën e Bashkisë Durrës dhe znj.Eneida Marku koordinatorë e projektit “Bashki të Forta” .